Vendim nr. 305, datë 28.09.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Asim Vokshi,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 28.09.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (N) 2026 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **NAZMIJE SHABA, VASIL ARBAÇI,** përfaqësuar nga avokati Sabri Karaj, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. (11-2015-2564) 984, datë 29.05.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nr. 10-2016-1458 (610), datë 22.06.2016 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2025-3957, datë 05.11.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 41, 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të**

Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin nr. 757, datë 24.02.1995 (*vendimi nr.757/1995*), Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*KKKP*), Durrës ka vendosur t'i rikthejë pronësinë e një ndërtese trekatëshe, të ndodhur në lagjen 1 të qytetit të Durrësit, ish-pronarit Xh.T., pasi ai ka paraqitur si dokumente provuese notën e transkriptimit, vërtetimin e pronësisë të lëshuar nga Zyra e Hipotekës Durrës, ku në bazë të aktit publik nr. 11473/6834, datë 12.09.1942, ish-pronari Xh.T. kishte blerë nga shtetasi S.K. një sipërfaqe toke prej një dynym e gjysmë, në vendin e quajtur "Jalli", në Durrës, kundrejt çmimit 400 franga shqiptare, si dhe vendimin nr. 80, datë 30.03.1943 të Bashkisë Durrës, (Zyra Teknike e Bashkisë) për lejen e ndërtimit mbi truallin në pronësi të tij. Sipas vlerësimit të ekspertëve, raporti i kontributit të shtetit ndaj pronarit ishte 16.65 % në favor të shtetit, ndaj, në këto kushte, KKKP-ja, Durrës ka vlerësuar se prona duhet t'i kthehej ish-pronarit pa shpërblim dhe pa detyrim financiar ndaj shtetit ose palëve të treta, ndërsa shteti të mbante detyrimin për kompensimin e personave që kishin paguar çmimin e shitjes në kohën e tjetërsimit. Më pas, prona e rikthyer është regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (*ZVRPP*), Durrës në datën 09.03.1995.

2. Po kështu, me vendimin nr. 941, datë 14.08.1995, KKKP-ja, Durrës i ka njohur ish-pronarit Xh.T. të drejtën e pronësisë edhe mbi një sipërfaqe toke truall prej një dynym e gjysmë, mbi të cilën është ndërtuar një ndërtesë trekatëshe, në lagjen nr. 1 të qytetit të Durrësit, blerë shtetasit S.K. kundrejt çmimit 4000 franga shqiptare dhe akti i shitblerjes është transkriptuar në Zyrën e Hipotekës Durrës në datën 21.10.1942.

3. Ndërkohë, kërkuesit kanë qenë banorë me statusin e qiramarrësve në godinën trekatëshe, nr. 9, të ndodhur në lagjen nr. 1, rruga "Nako Spiru", Durrës. Pas miratimit të ligjit nr.

7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore" (*Ligji për Privatizimin*), kërkuesit së bashku me banorë të tjerë të godinës, i janë drejtuar ish-Ndërmarrjes Komunale Banesa (*NKB*), Durrës, me kërkesë për privatizimin e banesave që kishin në përdorim, por kjo e fundit ka refuzuar privatizimin e këtyre banesave në favor të qiramarrësve, me arsyetimin se godina ishte pronë private.

4. Në vijim të refuzimit për privatizimin e banesave të tyre, kërkuesit dhe banorët e tjerë të godinës trekatëshe i janë drejtuar gjykatës me padi, me objekt detyrimin e palës së paditur, ish-NKB-së, Durrës, të privatizojë banesat në emrin e banorëve. Me vendimin nr. 832, datë 08.03.1994, Gjykata e Rrethit Durrës ka vendosur pranimin e padisë, duke detyruar ish-NKB-në, Durrës të kryejë veprimet për privatizimin e banesave në godinën trekatëshe në favor të qiramarrësve. Në zbatim të këtij vendimi janë lidhur kontratat e shitblerjes, në datën 14.06.1994, ndërmjet ish-NKB-së, Durrës dhe familjes së kërkueses Nazmije Shaba për apartamentin nr. 9 të godinës trekatëshe, si dhe ndërmjet ish-NKB-së, Durrës dhe familjes së kërkuesit Vasil Arbaçi për apartamentin nr. 5, të ndodhur në të njëjtën godinë.

5. I ndodhur në këto kushte, shtetasi Xh.T. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Durrës me kërkesëpadi, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë së kontratave të shitblerjes së Entit të Banesave Durrës (ish-NKB-ja) me banorët e godinës, ku përfshihen edhe familjet e kërkuesve. Me vendimin nr. 2409, datë 07.09.1995, Gjykata e Rrethit Durrës ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se kontratat janë lidhur bazuar në Ligjin për Privatizimin, ndërkohë që ish-pronari ka qenë debitor me shtetin për mospagim të tatimit të jashtëzakonshëm dhe në vitin 1947 i është marrë godina ende e papërfunduar, me vlerë 927.825 lekë të vjetra dhe është përfunduar nga shteti, duke shpenzuar ky i fundit 5.276.000 lekë të vjetra, pothuajse pesëfishin e vlerës. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 5655, datë 22.12.1995, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë. Ndërkohë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1739, datë 19.11.1996, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit, pranimin e kërkesëpadisë së shtetasit Xh.T. dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratave të shitblerjes të lidhura mes ish-NKB-së, Durrës dhe banorëve të godinës, si dhe qëndrimin e banorëve në apartamentet e tyre në pozitat e qiramarrësve sipas kushteve që parashikon ligji nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave" (*Ligji për Kompensimin*).

6. Në zbatim të vendimit nr.1739, datë 19.11.1996 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ish-NKB-ja, Durrës, me vërtetimin e datës 20.02.1997, ka konfirmuar njoftimin e banorëve të godinës trekatëshe se kjo e fundit kishte kaluar në pronësi të ish-pronarit Xh.T. dhe nga muaji nëntor i vitit 1996 qiraja për banesat do t'i paguhej pronarit. Në vijim, me qëllim zbatimin e aktit normativ nr. 3, datë 01.03.2012 "Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuara" (*akti normativ nr.3/2012*) dhe të ligjit nr. 82, datë 13.09.2012 "Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 3, datë 01.08.2012 të Këshillit të Ministrave", Enti i Banesave, Drejtoria Rajonale Durrës, ka nxjerrë titullin ekzekutiv nr. 398, datë 14.11.2012 "Njoftim konfirmimi", në zbatim të vendimit nr. 757/1995 të KKKP-së, Durrës, ndërkohë që me vendimin nr. 3906, datë 20.11.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit në favor të familjes të ish-pronarit Xh.T. Në vijim, sipas vendimit nr. 356, datë 28.02.2013 të shoqërisë përmbarimore private "Albase" sh.p.k., ka rezultuar se titulli ekzekutiv është ekzekutuar plotësisht, është bërë lirimi i godinës nga ana e ish-qiramarrësve dhe, për pasojë, është vendosur pushimi i ekzekutimit të titullit.

7. Ndodhur në këto kushte, kërkuesja Nazmije Shaba i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesëpadi, me objekt: (i) anulimin e vendimit nr. 757/1995 të KKKP-së, Durrës në emër të shtetasit Xh.T.; (ii) pavlefshmërinë e regjistrimit hipotekar nr. 597, datë 09.03.1995 të vendimit nr. 757/1995 të KKKP-së, Durrës; (iii) detyrimin e ZVRPP-së, Durrës të fshijë nga regjistri regjistrimin në emër të të paditurve të pasurive të trajtuara me vendimin nr. 757/1995 të KKKP-së, Durrës, regjistruar fillimisht me nr. hipoteke 597, datë 09.03.1995 në ZVRPP-në, Durrës dhe regjistrimet në vijimësi të këtij numri hipotekar, (iv) detyrimin e Bashkisë Durrës dhe të Entit Kombëtar të Banesave, Drejtoria Rajonale Durrës, të bëjnë privatizimin në favor të paditëses sipas kontratës së qirasë që ajo ka në pallatin trekatësh, nr. 9, Durrës, duke pretenduar gjithashtu investim më të madh shtetëror. Palë të paditura në procesin gjyqësor janë thirrur trashëgimtarët (si dhe trashëgimtarët e njërit prej tyre) të shtetasit X.T. dhe person i tretë kërkuesi Vasil Arbaçi.

8. Po kështu, kërkuesja Nazmije Shaba ka depozituar kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (*Prokuroria e Durrësit*), e cila, me vendimin e datës 12.03.2013, ka konstatuar mungesë parregullsish në vendimin nr. 757/1995 të KKKP-së dhe ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. 183/2013.

9. Me vendimin nr. (11-2015-2564) 984, datë 29.05.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, me arsyetimin se me vendim gjyqësor të formës së prerë është vlerësuar i drejtë vendimi i KKKP-së, Durrës, që i ka njohur dhe kthyer pronën shtetasit Xh.T. dhe po me vendim gjyqësor të formës së prerë është vlerësuar se prona "godinë trekatëshe" nuk ka qenë objekt trajtimi nga Ligji për Privatizimin. Sipas gjykatës së shkallës së parë, janë deklaruar absolutisht të pavlefshme kontratat e privatizimit të banesave të godinës trekatëshe, të lidhura ndërmjet ish-NKB-së, Durrës dhe ish-qiramarrësve të shtetit, ndër të cilët edhe familjet e kërkuesve. Gjithashtu, sipas gjykatës së shkallës së parë, është përcaktuar statusi i këtyre familjeve si qiramarrës në banesën e pronarit, në përputhje me përcaktimet e Ligjit për Kompensimin, ndërkohë në përputhje me përcaktimet e aktit normativ nr. 3/2012 është realizuar procedura e lirimit të kësaj godine në favor të pronarit nga ish-qiramarrësit e shtetit. Gjykata e shkallës së parë ka referuar edhe vendimin e Prokurorisë së Durrësit, ku sipas kësaj të fundit nuk janë konstatuar parregullsi ose paligjshmëri në vendimin e KKKP-së, Durrës që i ka njohur dhe kthyer pronën ish-pronarit Xh.T. Gjatë analizimit të çështjes ajo gjykatë ka vlerësuar se ndodhej përpara gjësë së gjykuar dhe një konflikt midis të njëjtave palë ndërgjyqëse (trashëgimtarët e tyre), me të njëjtin objekt material (godinën trekatëshe) dhe me të njëjtat pretendime, i zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë (nr. 1739, datë 19.11.1996 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë), nuk mund të gjykohet përsëri, pasi pretendimet, si dhe dokumentet përkatëse janë marrë në shqyrtim dhe janë analizuar edhe në gjykimin e mëparshëm. Po kështu, sipas gjykatës së shkallës së parë godina trekatëshe që rezulton e regjistruar në pronësi të trashëgimtarëve ligjorë të shtetasit Xh.T. është fizikisht e liruar nga ish-qiramarrësit e shtetit dhe faktikisht e pabanueshme, për rrjedhojë kërkuesit nuk mund të mbështesin pretendime pronësie mbi godinën e trajtuar me vendimin e KKKP-së në emër të shtetasit Xh.T., me argumentin se ajo është pronë shtetërore apo se investimi shtetëror ka qenë më i madh se ai i pasqyruar në vendim. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesit.

10. Me vendimin nr. 10-2016-1458 (610), datë 22.06.2016, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar drejt në rastin konkret, pasi jemi përpara "gjësë së gjykuar" dhe se një konflikt i zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë, vendimi nr. 1739, datë 19.11.1996 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nuk mund të gjykohet përsëri, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe. Sipas gjykatës së apelit, bëhet fjalë për të njëjtin objekt material, godinën trekatëshe dhe për të

njëjtat pretendime (shtetasi Xh.T. ka pretenduar ligjshmërinë e vendimit të KKKP-së, ndërsa kërkuesit kanë pretenduar se godina trekatëshe nuk duhet t'i ishte kthyer ish-pronarit, pasi vlera e investimit shtetëror në këtë godinë është më e lartë se 16.65 %, por duhej të ishte konsideruar si banesë shtetërore dhe duhej të ishte privatizuar në bazë të Ligjit për Privatizimin në favor të qiramarrësve të shtetit). Gjykata e apelit ka vlerësuar të drejtë përcaktimin e gjykatës së shkallës së parë se kërkuesja paditëse nuk ka legjitimim aktiv, pasi nuk ka as interesin e ligjshëm në ngritjen e padisë. Sipas gjykatës së apelit, pretendimi i kërkueses paditëse për vlerësim të pasaktë të vlerës së godinës trekatëshe të ish-pronarit në raport me vlerën e investuar nga shteti nuk qëndron, pasi e drejta e vlerësimit u është atribuuar KKKP-ve me Ligjin për Kompensimin. Ajo gjykatë ka vlerësuar se në rastin konkret KKKP-ja, Durrës ka përcaktuar se vlera e investimeve të shtetit, në raport me vlerën e ish-pronës së pronarit, është 16.6 %, pra më e vogël se 20 % dhe në këto rrethana kjo pronë i kalon në pronësi ish-pronarit pa asnjë lloj restituimi në vlerë. Gjithashtu, sipas gjykatës së apelit, godina trekatëshe rezulton e regjistruar në pronësi të trashëgimtarëve ligjorë të shtetasit Xh.T. dhe fizikisht është liruar nga ish-qiramarrësit e shtetit, ndërsa faktikisht rezulton të jetë e pabanueshme, si dhe nuk rezulton që kërkuesja paditëse të jetë pronare e godinës së trajtuar me vendimin e KKKP-së, Durrës që kundërshtohet gjyqësisht dhe as që ta ketë në përdorim kundrejt qirasë ndonjë pjesë ose ambient në këtë godinë. Po kështu, kërkuesja paditëse nuk ka statusin e qiramarrëses as në raport me shtetin, as në raport me pronarin e ndërtesës, si dhe asnjë prej kërkuesve nuk banon më në atë godinë. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs kërkuesit, si dhe kundërrekurs pasardhësit e shtetasit Xh.T.

11. Me vendimin nr. 00-2025-3957, datë 05.11.2025, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekurseve, me arsyetimin se ata nuk përmbajnë shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Sipas Gjykatës së Lartë, nuk ka zbatim të gabuar të ligjit material ose shkelje të natyrës procedurale në raport me vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, si dhe palëve ndërgjyqëse u është dhënë mundësia të realizojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes, të paraqesin prova, të njihen me provat e palës kundërshtare, të debatojnë në lidhje me to, të shprehin qëndrimin e tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, duke u respektuar të gjitha parimet bazë të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor.

12. Në datën 04.06.2026 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit

Organik të Gjykatës, është regjistruar më 18.06.2026. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesve

13. *Kërkuesit*, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u është cenuar e *drejta për proces të rregullt ligjor* në lidhje me të drejtën e pronës, në drejtim të:

13.1. *Së drejtës së aksesit substancial,* pasi kërkuesit nuk janë njoftuar për zhvillimin e gjykimit në dhomën e këshillimit në datën 05.11.2025 nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke cenuar të drejtën për t'u njoftuar.

13.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme,* pasi gjykatat e faktit në mënyrë antikushtetuese u kanë hequr të drejtën e pronës duke i lënë të pastrehë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk i ka dhënë përgjigje asnjë prej shkaqeve të rekursit, veçanërisht pretendimit për vlerësimin e pasurisë së kthyer ish-pronarit, megjithëse shteti ia kishte konfiskuar për mospagim të taksave, si dhe kontributi i ish-pronarit ishte 327.825 lekë, ndërsa i shtetit arrinte vlerën totale prej 5.276.000 lekësh ose 6-7% të saj.

13.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar lidhur me të drejtën e pronësisë së fituar nga kërkuesit dhe të kaluar padrejtësisht ish-pronarëve.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës*

14. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit

71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Kërkuesit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi. Po kështu, ata plotësojnë edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, pasi i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi kanë shteruar në formë e në substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis,* pasi vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është i datës 05.11.2025 dhe është publikuar në faqen zyrtare të asaj gjykate në datën 24.02.2026, datë në të cilën u është komunikuar edhe kërkuesve nëpërmjet postës elektronike, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 15.04.2026, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i Ligjit Organik të Gjykatës.

16. Për sa i përket legjitimimit *ratione materiae,* Kolegji vëren se kërkuesit kanë pretenduar cenimin e procesit të rregullt ligjor të lidhur me *të drejtën e pronës* në drejtim të së *drejtës së aksesit substancial, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*.

17. Kërkuesit kanë pretenduar *cenimin e së drejtës së aksesit substancial,* pasi ata nuk janë njoftuar për zhvillimin e gjykimit në dhomën e këshillimit në datën 05.11.2025 nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pra duke pretenduar në thelb cenimin e së drejtës për t'u njoftuar. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta për t'u njoftuar dhe për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, ndërsa kjo e drejtë, ndër të tjera, i krijon një pale ndërgjyqëse

të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare *(shih vendimet nr. 40, datë 14.09.2023; nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 49, datë 22.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese).*

18. Në lidhje me procedurat e rekursit, Kolegji vëren se neni 480 i KPC-së parashikon shqyrtimin e tij për kushtet e pranueshmërisë në dhomën e këshillimit. Më tej, në rastin kur rekursi plotëson kushtet e pranueshmërisë, çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore, si rregull, në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve (neni 482 i KPC-së) ose në prani të palëve (neni 482/a i KPC-së), shqyrtim për të cilin palët njoftohen për ditën, orën dhe përbërjen e trupit gjykues, të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, përmes shpalljes në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual, kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit.

19. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me rekurset e kërkuesve, të cilat janë shqyrtuar në dhomën e këshillimit të datës 05.11.2025. Njoftimi për shqyrtimin e çështjes është publikuar në datën 20.10.2025, në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë. Në datën e planifikuar (05.11.2025), Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar rekurset, duke vendosur mospranimin e tyre, mbështetur në nenin 480/1, shkronja "a", të KPC-së. Rekurset e kërkuesve i janë nënshtruar shqyrtimit paraprak të pranueshmërisë, shqyrtim ky që lidhet me verifikimin e kushteve formale të paraqitjes së tyre dhe të ekzistencës së shkaqeve të lejuara nga ligji, qoftë në aspektin formal, ashtu edhe në atë substancial, duke u mbështetur në aktet e dosjes gjyqësore. Po kështu, palët në rastin konkret janë njoftuar në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji, nëpërmjet afishimit publik. Në kuadër të rrethanave të rastit konkret, Kolegji konstaton se kërkuesit kanë ushtruar lirisht të drejtën e ankimit në një gjykatë më lartë, të rekursit në këtë rast, ndërkohë që për sa i përket cenimit të pretenduar të së drejtës për t'u njoftuar nga Gjykata e Lartë, ata nuk kanë parashtruar mjaftueshëm argumente sesi ajo mënyrë njoftimi nga ana e asaj gjykate mund dhe ka passjellë në realitet cenimin e ndonjë të drejte procedurale të lidhur dhe të ndërvarur nga ajo. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ky pretendim i kërkuesve nuk mund të merret në shqyrtim.

20. Kërkuesit kanë pretenduar cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme,* pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk u kanë kthyer përgjigje pretendimeve të tyre. Nga ana tjetër, kërkuesit kanë pretenduar se u është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit

nga Gjykata e Lartë, pasi kjo e fundit nuk ka arsyetuar lidhur me të drejtën e pronësisë së fituar nga kërkuesit dhe të kaluar padrejtësisht ish-pronarëve. Referuar argumenteve të kërkuesve për këto pretendime që, në thelb, kanë të bëjnë me mosmarrjen përgjigje të arsyetuar për pretendimet e ngritura në gjykim dhe në rekurs lidhur me interesat e tyre pasurorë, Kolegji vlerëson t'i trajtojë ato në këndvështrim të *së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*, të cilat *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin e Gjykatës, ndaj do të analizohen në vijim.

21. *Për pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*

22. Kërkuesit kanë pretenduar se gjykatat e faktit nuk kanë arsyetuar lidhur me të drejtën e pronësisë së fituar nga kërkuesit dhe të kaluar padrejtësisht ish-pronarëve, si dhe Gjykata e Lartë nuk i kanë dhënë përgjigje asnjë prej shkaqeve të rekursit, veçanërisht pretendimit për vlerësimin e pasurisë së kthyer ish-pronarit, megjithëse shteti ia kishte konfiskuar për mospagim të taksave, si dhe kontributi i ish-pronarit ishte 327.825 lekë, ndërsa i shtetit arrinte vlerën totale 5.276.000 lekë ose 6-7% të saj.

23. Në jurisprudencën e saj Gjykata e ka vlerësuar të drejtën e aksesit si një nga aspektet e së drejtës për proces të rregullt ligjor, që nënkupton të drejtën e individit jo vetëm për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe për të marrë një përgjigje përfundimtare të arsyetuar prej saj për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 17, datë 24.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në lidhje me arsyetimin e vendimeve gjyqësore, Gjykata është shprehur se funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë *(shih vendimet nr. 31, datë 29.05.2023; nr. 12, datë 19.03.2015; nr. 33, datë 08.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese).* Për vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë, Gjykata ka theksuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit *(shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese).* Për sa u përket funksioneve

të kolegjit të Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit paraprak të rekurseve në dhomën e këshillimit, Gjykata ka pohuar se në rast se kolegji krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 59 datë 23.07.2015; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese).*

25. Nga ana tjetër, Gjykata në mënyrë konstante në jurisprudencën e saj ka pohuar se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi dhe zbatimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 7, datë 07.02.2017; nr. 13, datë 10.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesja Nazmije Shaba ka vënë në lëvizje gjykatën e shkallës së parë me kërkesëpadi për anulimin e vendimit 757/1995 të KKKP-së, Durrës dhe të veprimeve juridike të ndërmarra në zbatim të tij dhe privatizimin e pronës në favor të paditëses (*shih paragrafin 7 të vendimit*). Gjykata e shkallës së parë ka rrëzuar padinë me arsyetimin se me vendim gjyqësor të formës së prerë është vlerësuar i drejtë vendimi i KKKP-së, Durrës që i ka njohur dhe kthyer pronën shtetasit Xh.T., ndërkohë që prona godinë trekatëshe nuk ka qenë objekt trajtimi nga Ligji për Privatizimin, duke sjellë si pasojë deklarimin e pavlefshmërisë absolute të kontratave të privatizimit të banesave të lidhura ndërmjet ish-NKB-së, Durrës dhe ish-qiramarrësve të shtetit, ndër të cilët edhe familjet e kërkuesve (*shih paragrafin 9 të vendimit*). Mbi ankimin e kërkuesve, gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë, duke vlerësuar se ndodhej përpara gjësë së gjykuar dhe se një konflikt i zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë nuk mund të gjykohet përsëri, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe. Po kështu, sipas gjykatës së apelit, e drejta e vlerësimit u përket KKKP-ve dhe në rastin konkret KKKP-ja, Durrës ka përcaktuar se vlera e investimeve të shtetit, në raport me vlerën e ish-pronës së pronarit, është më e vogël se 20 %, ndaj kjo pronë i kalon në pronësi ish-pronarit pa asnjë lloj restituimi në vlerë. Ndërkohë, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke arsyetuar se nuk ka zbatim

të gabuar të ligjit material ose shkelje të natyrës procedurale në raport me vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta.

27. Nga sa më lart, Kolegji konstaton se kërkuesit kanë ushtruar lirisht të drejtën e aksesit në të tria shkallët e gjykimit, duke iu garantuar atyre e drejta për të paraqitur pretendime në gjykim, sikundër edhe për të paraqitur ankim në gjykatat më të larta, duke marrë përgjigje nga ato. Në këtë drejtim, vendimet e gjykatave të faktit tregojnë mjaftueshëm rrethanat e çështjes, pretendimet e palëve, faktet e pranuara, përfundimet e nxjerra prej tyre, si dhe bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur zgjidhja e mosmarrëveshjes në atë mënyrë. Ato gjykata, pasi kanë vlerësuar pretendimet e palëve, kanë rrëzuar padinë e kërkueses me arsyetimin se me vendim gjyqësor të formës së prerë është vlerësuar i drejtë vendimi i KKKP-së, Durrës, që i ka njohur dhe kthyer pronën shtetasit Xh. T. dhe po me vendim gjyqësor të formës së prerë është vlerësuar se prona "godinë trekatëshe" nuk ka qenë objekt trajtimi nga Ligji për Privatizimin. Ndërkohë, vendimi i Gjykatës së Lartë, ndonëse me arsyetim të kufizuar, tregon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta dhe ka listuar shkaqet e ngritura në rekurse, si dhe vlerësimin se ato shkaqe nuk parashikohen nga ligji, duke përmbushur standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit. Vetëm fakti se në përfundim të procesit gjyqësor gjykatat e zakonshme kanë dhënë një vendim jo në favor të kërkuesve, nuk mjafton për të provuar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

28. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja "e", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.